



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KËSHILLI I MINISTRAVE**

**VENDIM**

**Nr. 5, datë 07.01.2009**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 96, DATË 03.02.2008 TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR AKTIVET NË MBULIM TË  
PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE, DHE INVESTIMET E  
TYRE NGA SHOQËRITË E SIGURIMEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 105 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.96, datë 03.02.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën b, të pikës 4, shprehja “... 20 për qind të provigjoneve teknike dhe matematike...” zëvendësohen me “...30 për qind të provigjoneve teknike dhe matematike...”
2. Pika 5, shfuqëzohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Sali Berisha**